



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 18.10.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.2) të Rregullores për Prokurim Publik të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 15.10.2024, të parashtruar nga Operatori ekonomik **SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A.- DEGA KOSOVË**, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Retender - Sigurimi dhe regjistrimi i automjeteve zyrtare”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-8439-2-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-059-221, nxjerr:

V E N D I M

1. Aprovohet si e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori ekonomik **SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A.- DEGA KOSOVË**, e dt.15.10.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Retender - Sigurimi dhe regjistrimi i automjeteve zyrtare”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-8439-2-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-059-221, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të publikuar me datë 10.10.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. Anullohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë:10.10.2024;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që ta kthejë lëndën në ri-vlerësim.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

Arsyetim

Operatori ekonomik **SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A.- DEGA KOSOVË** me dt.15.10.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Retender - Sigurimi dhe regjistrimi i automjeteve zyrtare”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-8439-2-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-059-221.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 18.10.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Gjatë shqyrtimit të kërkesës juaj për rishqyrtim të dt.15.10.2024, Autoriteti kontraktues, ka vërejtur se në fazën e kërimit të sqarimeve shtesë ka ndodhur një gabim teknik, ku juve ju është përcjellë letra standarde për kërkimin e sqarimeve shtesë e procedurës së kaluar(në emër të një OE tjetër), prandaj kërkesa juaj për rishqyrtim është e bazuar dhe Autoriteti kontraktues do ta kthejë lëndën në ri-vlerësim.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit